



Maqedonia (Rangu 1)

Maqedonia është burim, vend tranzitimi dhe vend destinacioni për trafikimin e grave dhe fëmijëve për qëllime të eksploatimit seksual për tregëti. Gratë dhe fëmijët në Maqedoni trafikohen brenda vendit, zakonisht prej zonave rurale në lindje në kafene urbane në Maqedoninë perëndimore. Viktimat që trafikohen në Maqedoni nga jashtë janë kryesisht nga Serbia dhe Shqipëria. Viktimat nga Maqedonia dhe viktimat që tranzitojnë nëpër Maqedoni trafikohen në Evropën Jugore, Qendrore dhe Perëndimore, duke përfshirë Bosnjën, Serbinë, Italinë dhe Suedinë.

Qeveria e Maqedonisë u përmbahet plotësisht standardeve minimale për eliminimin e trafikimit. Qeveria bëri përparim të dukshëm gjatë vitit të fundit: përforcoi kapacitetet për identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave, që rezultoi në rritje të madhe të numrit të viktimave të identifikuar, ndërsa një numri dukshëm më të madh të viktimave u është ofruar dhe u është dhënë ndihmë. Përpyekjet këmbëngulëse të qeverisë për ndjekje rezultuan me një numër më të madh të trafikantëve të dënuar.

Rekomandime për Maqedoninë: Të demonstrohet progres i dukshëm në mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave, duke përfshirë finasim të zmadhuar të strehimoreve për viktimat e vendit dhe mbështetje të vazhdueshme për OJQ-të që ofrojnë shërbime për viktimat; në mënyrë proaktive të implementohen procedurat e reja standarde për veprim për identifikimin e viktimave, si dhe periudhën për pasqyrim të rri të viktimave të jashtme; fuqimisht të ndiqen trafikantët sipas ligjit të përmirësuar për kundër trafikim dhe kornizave për dënimet, duke u siguruar që trafikantët e dënuar të kalojnë kohë adekuate në burg; të vazhdojnë të ndjekin fuqimisht çdo korrupsion të lidhur me trafikimin dhe të zgjerojnë përkushtimin për zvogëlimin e kërkesës për shërbime seksuale me qëllim që të edukohen klientët e tregëtisë seksuale në lidhje me trafikimin.

Ndjekja penale:

Qeveria e Maqedonisë e ngriti nivelin e përkushtimit të saj për zbatimin e ligjit në vitin 2007. Qeveria ndalon trafikimin për shfrytëzim seksual dhe për punë nëpërmjet të kodit penal të vitit 2004; neni 418 për të gjitha format e trafikimit me njerëz; neni 418c mbi organizimin e grupit për trafikim; dhe neni 191i cili mbulon rastet e prostitucionit të detyruar. Dënimet e parashikuara për trafikimin me qëllim të eksploatimit seksual për përfitim komercial janë të nivelit të njëjtë si ato për përdhunim.

Në Janar 2008, qeveria e përmirësoi kodin penal, duke shtuar dënime më të rënda për ata të cilët trafikojnë ose kanë për qëllim trafikimin me të mitur si dhe për ata të cilët i shrytëzojnë shërbimet e viktimave të trafikimit, që të përfshijë të gjithë kornizën e krimeve të trafikimit dhe t'i përmbushë kërkesat e Protokollit të OKB për parandalimin, ndaljen dhe dënimin e trafikimit në njerëz. Në vitin 2007, qeveria ndoqi penalisht 55 raste të lidhura me trafikimin dhe dënoi 70 trafikantë të përfshirë në 30 raste, një përparim i dukshëm nga 54 dënime në 18 raste që kishte vitin e kaluar. Nga 70 trafikantët e dënuar, 52 morën dënim me burg prej një ose më shumë vjet. Derisa 39 nga 70 trafikantët u dënuan me akuzën për kontrabandë, që rezultoi me dënime prej 8 muaj deri në dy vjet, dënimet për 31 trafikantët u sollën në bazë të neneve 418a dhe 418c që parshikojnë dënim prej dy deri në nëntë vjet. Qeveria përpiloi dhe shpërndau një manual trajnimi gjithpërfshirës për policinë. Maqedonia poashtu e revidoi mënyrën se si sistemi gjyqësor e shqyrton trafikimin si pjesë e restrukturimit të përgjithshëm të gjyqësorit për periudhën e raportimit, përfshirë këtu edhe krijimin e një zyre të re qendrore për të koordinuar të gjitha ndjeket penale të trafikimit në vend dhe drejtimin e rasteve në një gjyq të vetëm. Qeveria u tërhoq nga ankimi në maj 2007 për dënimet që ju dhanë dy policëve në vitin 2006 për krime të lidhura me trafikimin. Në mars 2008 qeveria e filloi ndjekjen penale për një rast të janarit 2007 që përfshinte pesë policë dhe një zyrtar të Ministrisë së Drejtësisë, të akuzuar për përzjerje në trafikim.

Mbrojtja

Qeveria e Maqedonisë bëri përpjekje domethënëse për identifikimin e viktimave të trafikimit dhe identifikoi 249 viktima (152 të huaja dhe 97 të Maqedonisë në vitin 2007), në krahasim me 17 që kishte në 2006. Qeveria u ofroi ndihmë që përfshinte, mbrojtjen, ndihmën ligjore e mjekësore, mbrojtjen e dëshmitarit, ndihmë psikologjike dhe ndihmë profesionale për të gjitha viktimat potenciale në vitin 2007. Megjithatë, në bazë të të dhënave të ofruara nga OJQ-të, IOM dhe agjensitë qeveritare për ndihmë të viktimave, më pak se një e treta e viktimave potenciale të identifikuar e pranuan këtë ndihmë dhe mbrojtje. Edhe pse qeveria i inkurajon viktimat të marrin pjesë në hetime dhe seanca gjyqësore, koha e shkurtër e shprehjes së dëshmisë i ka bërë disa viktima të bien në mëdyshje që të identifikohen ose t'i denoncojnë eksploatuesit e tyre. Në janar 2008, qeveria futi në përdorim një leje qëndrimi të zgjatur, dymujore, për viktimat e huaja që t'u japë mundësi të marrin ndihmë dhe të vendosin se a do të dëshmojnë kundër trafikantëve të tyre. Kjo leje përfshin një leje shtesë gjashtë mujore në rastet kur vazhdojnë proceset gjyqësore.

Qeveria ka raportuar se asnjë viktimë nuk ka bërë kërkesë për një leje të tillë. Nuk ka raporte apo dëshmi se viktimat e trafikimit janë penalizuar nga autoritetet përkatëse për sjellje kundërligjshme të kryera si rezultat direkt nga ajo që kanë qënë të trafikuar. Gjatë verës të vitit 2007, një grup i përbashkët ndërministror/OJQ, ka shkruar dhe miratuar procedurat për veprim të plotë dhe të fokusuar për viktimat në të gjithë Maqedoninë me qëllim identifikimin proaktiv të viktimave. Këto procedura kanë qënë plotësisht të implementuara në të gjithë vendin, para se kryeministri, në janar 2008, t'i bëjë publike dhe aprovojë. Qeveria e shtoi ndihmën e saj për OJQ që kanë punuar në parandalim të trafikimit, si pjesë e planit të saj vjetor për ndihmë OJQ-ve. Qeveria mundësoi përafërsisht 11, 000\$ si mbështetje direkte dhe 62, 000\$ si mbështetje në mjete materiale për OJQ të cilat punojnë në parandalim të trafikimit, duke e përfshirë këtu edhe OJQ-në e cila e mban edhe strehimoren për viktimat vendore të trafikimit, si dhe ka ndjekur diskutimet në lidhje me shërbimet pa pagesë (pro-bono) nga mjekët e punësuar në spitalet shtetërore, avokatët, personeli i sigurimit dhe punëtorët për mbrojtje sociale në bashkëpunim me strehimoren e udhëhequr nga OJQ-ja për viktimat vendore.

Parandalimi

Qeveria e implementoi planin e saj kundër trafikimit në mënyrë proaktive gjatë periudhës së raportimit. E ka përmirësuar dukshëm koordinimin e përgjithshëm dhe aftësinë për mbledhje të statistikave në lidhje me trafikimin në vitin 2007, si dhe hapi një zyrë për koordinim nacional për antitrafikim në suaza të Ministrisë të punëve të brendshme. Zyra për mekanizëm nacional të referimit e përforcoi punën e 27 qendrave që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit, në të gjithë Maqedoninë. Qeveria mundësoi personel dhe mbështetje financiare për OJQ të cilat punuan në parandalimin dhe ngritjen e vetëdijes për trafikimin, duke përfshirë edhe përpjekjet për të edukuar klientët në lidhje me rreziqet shëndetësore dhe ligjore që i sjell seksi komercial. Në prill 2007, qeveria e kompletoi një pilot projekt të suksesshëm për edukim dhe integrim të dhjetë viktimave të trafikimit nga Maqedonia. Zyrtarët e Maqedonisë në të gjitha nivelet qeveritare morrën pjesë në kampanjën për vetëdijesim në lidhje me antitrafikimin. Qeveria shqyrtoi zvogëlimin e kërkesës nëpërmjet të mjeteve ligjore duke i miratuar amandamentet në kodin e saj penal në janar 2008, me të cilën i zmadhoi dënimet kundër klientëve të njohur të viktimave të trafikimit. Qeveria poashtu ofroi trajnim antitrafikimi për ushtarët me mision jashtë vendit.